



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:181590
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05501694

Ac.nr.4356/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Dardan Kadolli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës” Magjistratja Prishtinë - Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar D.H., kundër të paditurit Sh.G. nga fshati Komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson G.S., avokat në Lipjan, sipas autorizimit, për rimbursimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.374/17, datë 13.03.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.374/17, i datës 13.03.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.374/17, të datës 13.03.2020, ka vendosur si në vijim:

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Sh.G. nga fshati që paditëses Byrosë Kosovare të Sigurimit t'ia rimburoj shumën prej 390€, në emër të rimbursimit të dëmit dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar duke llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe t'i paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, si e pabazuar.

OBLIGOHET paditësja që t'ia paguaj të paditurit në emër të shpenzimeve për përfaqësim të autorizuarit të paditurit avokatit shumën prej 135 €.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i paditëses në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin ta ndryshoj dhe ta aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar, apo ta prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i të paditurit ka propozuar që ankesa e paraqitur nga paditësja të refuzohet si e pabazuar dhe paditësja të detyrohet që të paditurit në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në ankesë t'ia paguaj shumën prej 104 €.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se

Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj me datë 16.08.2017, kundër të paditurit në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për rimbursimin e dëmit, me të cilën ka kërkuar që të I. Miratohet kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë, si e bazuar, II. Detyrohet i paditur Sh.G. që paditëses Byrosë Kosovare të Sigurimit t'ia rimburoj shumën prej 390€, në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 23.11.2013, në Ll.... dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie deri në pagesën përfundimtare si dhe t'i paguaj shpenzimet e procedurës të cilat do ti caktoj kjo gjykatë në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.374/17, të datës 13.03.2020, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se me datë 23.11.2013, kishte ndodhur aksident trafiku i përshkruar në raportin policor nr....., gjersa shkaktar i aksidentit ishte i padituri Sh.G.. Nuk ishte kontestues fakti se paditësja ia ka kompensuar dëmin si rezultat i këtij aksidenti të dëmtuarit I.G. në shumë prej 390€, mirëpo duke iu referuar kundërshtimit të të paditurit gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë

çështje juridiko-civile, gjykata gjeti se në rastin konkret ka arritur parashkrimi i kërkesëpadisë së paditëses për rimbursim të dëmit ,pasi me dispozitat e nenit 357 të LMD-së, është paraparë ” Kërkesat e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhen për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”. Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi. Rrjedhimisht, mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar nga e cila ka rezultuar se paditësja me të dëmtuarin me datë 04.04.2014 kishte lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit, të dëmtuarit pagesa i është bërë me datë 16.04.2014, ndërsa padinë për rimbursim të dëmit e ka paraqitur me datë 16.08.2017, nga këto rrethana gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia është parashkruar, pasi padia është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor prej tre viteve. Prandaj nga arsyet e parashtruara gjykata vendosi që kërkesëpadinë ta refuzoj si të pabazuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 357 paragraf 1 dhe 376 paragraf 1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike të paraqitura nga paditësja, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk janë pranuar si të themelta për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë, respektivisht për parashkrimin e kërkesës nga padia.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se

Me nenin 341 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se “ Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit ”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se “ Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit ”.

Me nenin 342 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se “ Parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër ”.

Me nenin 357 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se “ Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marr në dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se e drejta e paditëses për të kërkuar rimbursimin e dëmit ndaj të paditurës është parashkruar, për arsye se rasti ka ndodhur me datë 23.11.2013, pagesa për shpërblimin e dëmit palës së dëmtuar i është bërë me datë 16.04.2014, ndërsa padia është paraqitur në gjykatë me datë 16.08.2017, e nga kjo rezulton se nga momenti i pagesës (që nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse) me të cilën është kompensuar pala e dëmtuar, e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë kanë kaluar 3 vite e katër muaj. çka do të thotë se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4356/20, me datë 13.03.2024

Kryetare e kolegjit

Hunaida Pasuli